



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 29.09.2025

Numër Protokolli: 6436/2025

A.nr.1104/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabami, anëtarë, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1104/2025, të datës 10.06.2025, të parashtruar nga ankuesja D.Sh, kundër organit të punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 29.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1104/2025, të datës 10.06.2025, të parashtruar nga ankuesja D.Sh.

A r s y e t i m

Ankuesja, D.Sh (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 10.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3906/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1104/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference **RN00016972**, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 07.03.2025, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Grupi i Arkiv dokumentacionit për pozitën e punës “Zyrtar për administrimin e dokumenteve”, klasa e pozitës Profesional 2, numri i kërkuar 1..

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 07.03.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00016972, Grupi i Arkiv dokumentacionit për pozitën e punës “Zyrtar për administrimin e dokumenteve”, klasa e pozitës Profesional 2, numri i kërkuar 1, ku afati për aplikim ka qenë nga data 08.03.2025 deri më 06.04.2025.

Tutje sipas provave materiale të çështjes del se në konkursin përkatës ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo me Njoftimin e datës 18.04.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve , rezulton se e njëjta nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, me arsyetimin se i mungon kualifikimi i kërkuar sipas kriterëve të konkursit.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve , më datë 07.05.2025, ka publikuar Njoftimin, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë me më së shumti pikë për pozitën është shpallur kandidatja fituese A.S me gjithësejt 82.5 pikë.

Ankuesja, pas publikimit të njoftimit përfundimtar për kandidatin e suksesshëm ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar refuzimin e aplikacionit me arsyetimin se e njëjta i ka plotësuar kriteret e konkursit.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati F.Z, si kandidate aplikuese në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016972, më datë 26.05.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.956/2025, të datës 23.07.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00016972, Grupi i arkiv-dokumentacionit për pozitën e punës “Zyrtar për administrimin e dokumenteve” Prizren, klasa e pozitës Profesional 2, si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1104/2025, të datës 10.06.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimi për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.956/2025, të datës 23.07.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi procedurën e pranimi me numër reference RN00016972, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesja në petitumin e ankesës atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1104/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1104/2025, të datës 10.06.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1104/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses D.Sh;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MFPT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.